

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 203, DATË 10.4.2019 E KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË MASËS SË PËRFITIMIT DHE LLOJEVE TË PUSHIMEVE TË TJERA, ME APO PA PAGESË, NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka për qëllim ndryshimin vendimit nr. 203, datë 10.4.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Ky projektvendim ka për objekt përmirësimin dhe qartësimin e rregullimit të trajtimit financiar të punonjësve me gradë të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në lidhje me orët shtesë të punës, punën gjatë natës, në ditët e pushimit javor dhe në festat zyrtare, si dhe përcaktimin e kufirit maksimal vjetor të orëve shtesë. Ndryshimet synojnë harmonizimin e trajtimit financiar me natyrën specifike dhe me risk të lartë të shërbimit operacional, unifikimin e praktikave të zbatimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, garantimin e mbrojtjes së të drejtave të punonjësve në raport me ngarkesën e punës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në katërmujorin e parë të programit analitik të projektakteve për vitin 2026, për ministrinë e Punëve të Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 203, datë 10.4.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” ka qenë detyrim ligjor i përcaktuar të pikës 5 të nenit 30 të ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *“5. Kriteret, masat e përfitimeve dhe llojet e pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”*

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 203, datë 10.4.2019 të Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ‘Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin’” synon unifikimin e trajtimit financiar dhe rregullimit normativ të orëve shtesë të punës për punonjësit me gradë të shërbimit të MZSH, në zbatim të Ligjit nr. 152/2015.

Projektvendimi eliminon paqartësitë ekzistuese të evidentuara gjaë zbatimit të vendimit nr. 203 datë 10.4.2019 të Këshillit të Ministrave, duke saktësuar përqindjet e kompensimit sipas fashave orare, natyrës së shërbimit dhe statusit të planifikimit në grafik. Kjo redukton interpretimet e ndryshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Vendimi aktual në fuqi rregullon vetëm orët shtesë dhe orët e punës gjatë natës vetëm për punonjësit e pa planëzuar dhe që thirren në shërbim, pa përcaktuar një qartësi lidhur me trajtimin e punonjësve të planëzuar në shërbim, të shërbimit të MZSH. Praktika të ndryshme zbatimi në nivel vendor Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë aplikuar interpretime të ndryshme lidhur me kompensimin e punës, duke krijuar pabarazi ndërmjet punonjësve.

Gjithashtu, referuar edhe vendimit nr. 4, datë 25.06.2024 të “Këshillit Konsultativ, Qeverisje Qendrore – Qeverisje Vendore”, pranë Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, i cili për projektvendimin e propozuar nga Kryeministria/DAP “Për miratimin e vlerave për sejcilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, rekomandoi dhe rregullimet përsa i përket trajtimit financiar për orët e shërbimit natën dhe ditët e festve zyrtare për punonjësit zjarrfikës.

Duke mos patur një praktikë të unifikuar, disa punonjës i kanë marrë pagesat për orët shtesë dhe orët e natës nëpërmjet vendimeve të gjykatave.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në nr. 203, datë 10.4.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Pikërisht referuar këtyre mangësive janë evidentuar, problematika serioze në rekrutime dhe largime në të gjitha nivelet e Shërbimit të MZSH. Me qëllim unifikimin e trajtimit dhe krijimit të qartësisë lidhur me këtë kategori punonjësish, lind nevoja për ndërhyrje në vendimin nr. 203 datë 10.4.2019 të Këshillit të Ministrave.

Nëpërmjet këtij këtij projektvendimi synohet dhe një rritje e motivimit dhe stabilitetit në shërbim. Unifikimi i trajtimit financiar ndikon drejtpërdrejt në motivimin e personelit operacional, duke forcuar gatishmërinë dhe performancën në situata emergjente.

Gjithashtu, garantohet një mbrojtje e shëndetit dhe sigurisë në punë, duke vendosur kufirin maksimal prej 200 orësh shtesë në vit për punonjësit operacionalë, një mekanizëm mbrojtës ndaj mbingarkesës dhe lodhjes profesionale, duke garantuar standarde minimale të sigurisë në punë.

Projektvendimi përbën një ndërhyrje të nevojshme dhe proporcionale në kuadrin rregullator të trajtimit financiar të punonjësve të MZSH-së. Ai adreson problematikat ekzistuese, forcon mbrojtjen e punonjësve dhe rrit efikasitetin institucional, duke krijuar një sistem më të drejtë, më të kontrolluar dhe më të qëndrueshëm në kohë.

Në këtë kuptim, miratimi i projektvendimit konsiderohet i domosdoshëm dhe me ndikim pozitiv në funksionimin e shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe krijon një përputhshmëri me parimet e legjislacionit të punës

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në përputhje me Kushtetutën, në zbatim të pikës 5 të nenit 30, të Ligjit nr.152, datë 21.12.2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Pika 1 e projektvendimit parashikon që pika 4, e vendimit nr. 203, datë 10.04.2019 të Këshillit të Ministrave ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për orët shtesë të punës/shërbimit, përfiton një shtesë mbi pagë në masën:

- a) 25% për çdo orë punë/shërbimi shtesë në ditë të zakonshme pune;
- b) 50% për çdo orë punë/shërbimi shtesë të kryer gjatë pushimit javor;
- c) 50% për çdo orë punë/shërbimi në ditët e festave zyrtare;
- ç) 50% për çdo orë punë/shërbimi nga ora 22:00 deri në orën 06:00;
- d) 20% për çdo orë punë/shërbimi nga ora 19:00 deri në orën 22:00”.

Pika 2 e projektvendimit parashikon që pas pikës 4, shtohet pika 4/1 dhe 4/2 me përmbajtjen:

“4/1. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, i planëzuar në shërbim sipas pikës 3 të këtij vendimi, përfiton një shtesë mbi pagë në masën:

- a) 50% për çdo orë pune shërbimi në ditët e festave zyrtare;
- b) 50% për çdo orë pune shërbimi të kryera nga ora 22:00 deri në orën 06:00;
- c) 50% për çdo orë punë shërbimi shtesë të kryer jashtë shërbimit 24 orësh të planëzuar”.

“4/2. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, i pa planëzuar në grafik shërbimi sipas pikës 3 të vendimit, në ditët e festave zyrtare përfiton:

- a) një ditë pushimi shtesë ose për shkak të natyrës së punës paguhet 8 orë shtesë të përlllogaritur mbi pagën orare.
- b) çdo orë pune shërbimi shtesë përlllogaritet mbi pagën orare të përcaktuar në pikën 2 të vendimit.”

Pika 3 e projektvendimit parashikon që pas pikës 6, shtohet pika 6/1 me përmbajtjen: “6/1. Numri maksimal i orëve shtesë për punonjësin operacional të shërbimit të MZSH-së nuk mund të jetë më shumë se 200 orë në vit. Me autorizimin e Inspektoratit të Shtetëror të Punës, numri maksimal i orëve shtesë mund të tejkalohet vetëm në rastet e forcës madhore ose të menaxhimit të emergjencave civile në dobi të popullsisë”.

Pika 4 e projektvendimit parashikon që për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në fund parashikohet hyrja në fuqi e vendimit, e cila ndodh pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

Efeket financiare nuk mund të përlogariten me saktësi, pasi edhe numri i orëve shtesë të pagueshme sipas përcaktimeve në këtë projektvendim, varet nga ngarkesa e paparashikuar dhe rastet emergjente ku nevojitet ndërhyrja e menjëhershme e strukturave të shërbimit të MZSH, të cilat janë kryesisht gjatë sezonit të verës.

Efekte e mundshme financiare, për trajtimin e njëtrajtshëm, të punonjësve të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në nivel vendor, përballohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

PROPOZUESI

MINISTRI

ALBANA KOÇIU